

NJOFTIM

Sot, më datë **11.04.2023**, ora **15:00**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Sokol Ibi (Relator);**
- 2. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 3. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 4. Edlira Petri (Anëtare);**
- 5. Alma Kolgjoka (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e godinës “Poli i Drejtësisë”, salla e konferencave të KLGJ-së, në adresën: Rruga “Ana Komnena”, Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.8 Regj.Themeltar, Datë 05.04.2023 Regjistrimi, me:

PADITËS: MEHMET NELAJ, i përfaqësuar nga Avokati Zhuljen Ristani.

I PADITUR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE.

OBJEKTI: Kundërshtimin e Vendimit nr.38, datë 31.03.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndryshimin e tij duke pranuar kërkesën për regjistrimin e paditësit Mehmet Nelaj si kandidat për anëtar të Këshillit Bashkiak Sarandë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023.

BAZA LIGJORE:Neni 70 e vijues i Ligjit nr.74/2012, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

me Vendimin Nr. 8 datë 11.04.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e padisë.
2. Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të palës paditëse.
3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
4. U shpall në Tiranë më datë 11.04.2023.

Tiranë, më 11.04.2023

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë